

L I G J
Nr.8232, datë 19.8.1997

PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.8043, DATË 30.11.1995 "PËR KONTROLLIN E FIGURËS SË ZYRTARËVE DHE PERSONAVE TË TJERË QË LIDHEN ME MBROJTJEN E SHTETIT DEMOKRATIK", NDRYSHUAR ME LIGJET NR.8151, DATË 12.9.1996 DHE NR.8220, DATË 13.5.1997

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozim të një grupi deputetësh

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Në ligjin nr.8043, datë 30.11.1995 "Për kontrollin e figurës së zyrtarëve dhe personave të tjerë që lidhen me mbrojtjen e shtetit demokratik", ndryshuar me ligjet nr.8151, datë 12.9.1996 dhe nr.8220, datë 13.5.1997 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Në nenin 1:

a- hiqet gërma "a";

b- në gërmën "e" hiqen fjalët "kryetarët e bashkive"

2. Në nenin 5 në rreshtin e dytë dhe të tretë në vend të fjalëve "dhe vendimet e tij merren me shumicë votash" vihen fjalët "dhe dëshmia e verifikimit jepet me vlerësimin e shumicës".

3. Në nenin 7, gërma "ç", fjala "vendim zëvendësohet me fjalën "dëshmi e verifikimit".

4. Neni 8 ndryshohet si vijon:

"Komisioni jep dëshminë e verifikimit brenda 15 ditëve nga marrja e kërkesës. Në dëshmi argumentohet nëse personi i plotëson ose jo kërkesat e këtij ligji lidhur me funksionet e përmendura në nenin 1.

Kur në dëshminë e verifikimit vërtetohet se shtetasi nuk ka asnjë nga pengesat ligjore të përmendura në nenin 2 të këtij ligji, ky fakt duhet të pasqyrohet në të gjitha dokumentet e tij."

5. Në nenin 9:

a- paragrafi i parë dhe i dytë hiqen;

b- në paragrafin e tretë fjala "vendimit" zëvendësohet me fjalën "dëshmisë së verifikimit".

6. Neni 10 ndryshohet si vijon:

"Kundër dëshmisë së verifikimit të komisionit shtetëror personi mund të ankohet në gjykatën e apelit brenda 7 ditëve nga dita e komunikimit, dhe kjo e fundit duhet të vendosë brenda 15 ditëve."

7. Në nenin 11, fjala "vendimit" zëvendësohet me fjalët "dëshmisë së verifikimit". Po në nenin 11 fjalët "me përjashtim të rastit të përmendur në nenin 9, paragrafi i parë", hiqen.

8. Në nenin 16, në rreshtin e dytë fjala "vendime" zëvendësohet me fjalët "dëshmitë e verifikimit".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë.